



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESORE
VLORE

NR.REGJISTRIT THEMELTAR 296

Data e regjistrimit 16.05.2012

NR VENDIMI 296

Date vendimi date 14.06.2012

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR VLORE E PERBERE PREJ :

GJYQTARE : Anastasi SHEHU

Asistuar nga sekretare gjyqesore Enklerida Ngjela, ne Vlore sot me dt.14.06.2012,
mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dycr te hapura çeshtjen Nr.296 akti qe i
perket:

KERKUES :

[REDACTED] i biri i Sadikut dhe i Metes lindur me
29.06.1981 lindur dhe banues ne Vlore, Lagja [REDACTED] Rruga
[REDACTED] me arsim 8 klase,perfaqesuar nga

Av. [REDACTED] Anetar i Dhomes se Avokatisë Tirane me
Nr. [REDACTED] license dhe me Nr. NIPTI K [REDACTED]

OBJEKTI : Kthimin sendi te sekuestruar

Plaza Ligjore : Neni 480 te K.Pr.Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi ne teresi kerkesen, administroi provat e nevojshme, degjoi kerkuesin qe kerkoi te vendoset sipas objektit te kerkeses dhe pasi e bisedoi çeshtjen ne teresi;

VEREN

Kerkuesi [REDACTED] banon ne Lagjen "24 Maji" Vlore. Me vendimin nr.503 dt.02.12.2011 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore eshte vendosur si me poshte:

" Te deklarohet fajtor i pandehuri [REDACTED] per vepren penale te "Prodhim dhe mbajtje pa leje te armeve te zjarrit", dhe ne baze te nenit 278/2 te Kodit Penal te denohet me 1 (nje) vit e 6 (gjashte) muaj burgim.

Ne zbatim te nenit 406 te K.pr.Penale eshte denuar perfundimisht me 1 (nje) vit burgim"

Vendim i cili ka marre forme te prere dt. 21.02.2012 te Gjykates se Apelit Vlore".

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore ne vendimin e mesiperm nuk eshte shprehur lidhur me disponimin e provave materiale, ne pronesi te kerkuesit (te pandehurit) [REDACTED] dhe konkretisht:

1. Mjeti autoveture e markes BMW me targe [REDACTED] sekuestruar si prove materiale ne baze te nenit 190/1 te K.Pr.Penale.

Per mos shprehjen nga ana e Gjykates ne lidhje me disponimin e provave materiale te lartpermendura, kerkuesi [REDACTED] me kerkese drejtuar gjykates ka kerkuar kthimin e mjetit autoveture e markes BMW me targe [REDACTED], sekuestruar me proces

verbalin e dt.21.06.2011. Ne lidhje me kete prove prokurori i ceshitjes ne konkluzionet e tij perfundimtare eshte shprehur qe mjete autoveture e markes BMW me targe [redacted] sekuestruar si prove materiale ti kthehet te pandehur [redacted] si posedues i tij i ligjshem. Fakt ky qe nuk eshte shprehur nga ana e Gjykates ne vendimin e saj perfundimtar me Nr.503, date 02.12.2011.

Duke qene se kjo prove materiale aktualisht ndodhet e sekuestruar per llogari te procedimit penal Nr. 725 viti 2011 sipas proces verbalit te dt. 21.06.2011, kushtet ne te cilat ajo eshte lene ne ruajtje, gjykata bazuar ne Nenin 217 te K.Pr. Penale, çmon se kjo prove materiale duhet ti kthehet kerkuesit pasi vendimi ka marre forme te prere. Sa siper u provua me shpjegimet e vete paleve dhe provave shkresore qe jane te administruara ne dosje, prova keto qe bindin gjykatën se kthimi i ketyre provave materiale eshte kerkese e ligjeshme e kerkuesit [redacted]

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne Nenin 217 te K.Pr.Penale.

VENDOSI

Pranimin e kerkeses se kerkuesit [redacted]

Kthimin e proves materiale autoveture e markes BMW me targe [redacted] ne pronesi te kerkuesit [redacted]

Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen kerkuesit .

Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit .


U shpall ne Vlore me 14.06.2012 ora 11:30.

Sekretare

Enklerida Ngjela

Gjyqtare

Anastasi Shehu



[Handwritten signature]